

AKT THEMELIMI

I

SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"PSR" SHPK

Ortakët themelues si më poshtë:

- Z- Roberto De Berardinis , shtetas Italian, i datëlindjes 26/08/1967, lindur në San Benedetto Del Tronto, banues në Santa Egidis Alla Vibrata, (TE), Rruga Giacomo Matteotti nr.20, Itali, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. AT8818164
- Z. Alessi Stefano , shtetas Italian, i datëlindjes , 21/08/1962 lindur në Ascoli Piceno(AP), banues në Appignano Del Tronto (AP), Rruga Viale Rimembranze, nr.32, Itali, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. AX8718702

Pjesa e përgjithshme

Bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Ligjin Nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", sot me datë 24/01/2022 hartojnë këtë Akt – Themelimi si më poshtë vijon:

NENI 1

Emri

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin "PSR SH.P.K". Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 2

Forma

Shoqëria tregtare "PSR SH.P.K", ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qëndrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "PSR SH.P.K", do të ketë zyrën e saj qendrore ne:

Rruga: Durrës-Tiranë, Zone kadastrale 2574, Numer Pasurie 154/177, Volumi 23, Xhafzotaj, Durrës,

3.2 Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 4

1



Objekti i veprimtarisë

Shoqëria ka si objekt aktiviteti në Shqipëri dhe jashtë:

Prodhim kofeksione, veprimtari ne fushen e perpunimit aktiv, (fosoneri).

Import-eksport te artikujve te ndryshem industrial, tregti me shumice e pakice ushqimore, elektroshtepiake, elektronike, metrazhe, artikuj kozmetike, detergjente, prodhim e shitje te materialeve plastike.

Transport mallrash per vete dhe per te trete, kombetar dhe nderkombetar.

NENI 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë pa limit

NENI 6

Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

Shoqëria tregtare "PSR" SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7

Përgjegjësia e Ortakëve

Aksionerët nuk janë personalisht përgjegjës për detyrimet e kontraktuara nga shoqëria "PSR Shpk" dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e papaguar të kontributeve të nënshkruara (kapitali aksionar). Prandaj, aksionarët janë përgjegjës për detyrimet shoqërore vetëm brenda kufijve të pjesëve të kapitalit aksionar të paguar nga secili aksionar.

NENI 8

Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "PSR" SHPK është 100.000 (njqind mije) Leke, e ndarë në 2 kuota, i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga të gjithë ortakët.

8.2 Ortakët kanë kontribuar në krijimin e kapitalit të shoqërisë dhe zotërojnë kuotat e tyre në këtë mënyrë:

- Z - Alessi Stefano , është ortaku i shoqërisë, i cili zotëron 1 kuotë, pjesëmarrja në përqindje është e barabartë me 55% të kapitalit të shoqërisë, me vlere kapitali 55.000 (pesedhjetë e pese mije) Leke
- Z - Roberto De Berardinis , është ortaku i shoqërisë, i cili zotëron 1 kuotë, pjesëmarrja në përqindje është e barabartë me 45% të kapitalit të shoqërisë, me vlere kapitali 45.000 (dyzet e pese mije) Leke



NENI 9
Organet e shoqërisë

9.1 Organet e shoqërisë janë:

- Asambleja e ortakëve
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

9.2 Në rast zmadhimi të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, të gjithë ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë dhe shlyejnë pjesët e kapitalit të zmadhuar në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapital.

NENI 10
Administratori

10.1 Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Administratori i shoqërisë është Z. Alessi Stefano .

NENI 11

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje gjykatës kompetente.


Ky Akt-Themelimi përpilohet në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe.

ORTAKËT THEMELUES

Z. Alessi Stefano



Z. - Roberto De Berardinis



DURRES 24/01/2022